

Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve

(model i thjeshtuar nga Kombet e Bashkuara)

PJESA E PARE

1. Fëmijë është ajo qenie njerëzore deri në 18 vjeç.
2. Shtetet duhet të respektojnë, në territoret e tyre, të drejtat e të gjithë fëmijëve: handikapatë, të pasur apo të varfër, meshkuj ose femra, të çdo lloj race, besimi fetar etj.
3. Të gjithë ata që drejtojnë duhet t'i mbrojnë dhe t'u sigurojnë fëmijëve të gjitha ndihmat e nevojshme për mirëqënien e tyre.
4. Cdo Shtet duhet të zbatojë këtë Marrëveshje me impenjimin më të madh me anë të ligjeve, të financimeve dhe ndërhyrjeve të tjera. Në rast nevoje Shtetet më të varfëra duhet të ndihmohen nga ato më të pasura.
5. Shtetet duhet të respektojnë atë që kujdeset për fëmijën.
6. Fëmija ka të drejtën e jetesës. Shtetet duhet ta ndihmojnë që të rritet.
7. Kur lind një fëmijë ka të drejtë t'i vihet një emër, të regjistrohet dhe të ketë dashurinë e prindërve të tij.
8. Fëmija ka të drejtën e identitetit dhe të kombësisë së tij dhe të ketë gjithmonë marrëdhënie me familjen.
9. Fëmija nuk mund të ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tij. Ligji mund të vendosë një gjë të tillë kur fëmija keqtrajtohet. Fëmija i ndarë nga prindërit duhet të ketë mundësinë e mbajtjes së kontakteve me ta. Kur ndarja vjen si pasojë e veprimit të Shtetit (burgim i prindërve etj.) fëmija duhet të informohet mbi vendndodhjen e tyre.
10. Fëmija duhet të respektohet në jetën e tij private. Askush nuk mund të hyjë në shtëpinë e tij, të lexojë postën e tij ose të flasë keq për të.
11. Fëmija nuk mund të çohet ilegalisht në një Shtet tjetër.
12. Fëmija duhet të ketë mundësinë e shprehjes së mendimit të tij mbi të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me të. Kur merren vendime që kanë të bëjnë me të, para se të vendoset duhet të dëgjohet fëmija.
13. Fëmija ka të drejtë të shprehet lirisht me anë të fjalës, shkrimit, vizatimit, shtypit etj.
14. Shtetet duhet të respektojnë të drejtën e fëmijës mbi lirinë e mendimit, njohurive dhe besimit fetar. Prindërit kanë të drejtën dhe detyrën të udhëzojnë fëmijët në ushtrimin e të drejtave të tyre.
15. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shoqërimit dhe mbledhjeve paqësore (me persona të tjerë).

16. Fëmija ka të drejtë të njohë të gjitha informacionet e nevojshme për mirëqënien e tij. Shtetet duhet:

- të bëjnë filma, programe TV dhe materiale të tjera të nevojshme për fëmijët;
- të shkëmbejnë me Shtetet e tjera të gjitha materialet interesante për fëmijë;
- të mbrojnë fëmijët nga librat dhe materialet e tjera jo të përshtatshme për ta;

17. Prindërit (apo përgjegjësit ligjor) duhet të kujdesen për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Shteti duhet t'i ndihmojë për ta bërë sa më të lehtë detyrën e tyre.

18. Shteti duhet të përkujdeset për fëmijën që nuk mund të jetojë me familjen e tij dhe t'ia besojë atë dikujt tjetër. Kush përkujdeset për fëmijën duhet të respektojë mënyrën e tij të jetesës.

19. Shtetet duhet të lejojnë adoptimin në interes të fëmijës. Adoptimi duhet të autorizohet nga autoritetet perkatëse me pëlqimin e të afërmeve të fëmijës. Në rast se fëmija nuk mund të adoptohet në Shtetin e tij mund të jepet në adoptim në një Shtet tjetër. Adoptimi i një fëmije nuk duhet të kryhet kurrë për përfitim lekësh.

20. Shtetet duhet të kujdesen për fëmijët refugjatë dhe t'i ndihmojnë ata të bashkohen me familjet e tyre.

21. Fëmijët me probleme fizike ose mendore duhet të jetojnë një jetë të plotë dhe të kënaqshme bashkë me fëmijët e tjerë. Shtetet duhet t'i sigurojnë fëmijës assistencë falas në rast se prindërit ose përgjegjësit e tij janë të varfër. Fëmija ka të drejtë të shkojë në shkollë, të përgatitet për të punuar dhe të argëtohet.

22. Fëmija duhet të jetojë në mënyrë të shëndetshme dhe nëse është nevoja edhe me ndihmen e mjekimeve dhe ilaçeve. Ka të drejtë të ndihmohet në rast nevojë.

23. Fëmija që është kuruar ka të drejtë të vizitohet në mënyrë të vazhdueshme.

24. Cdo fëmijë duhet të kurohet dhe të ndihmohet në rast sëmundjeje ose nevojë ekonomike duke marrë parasysh mundësitë ekonomike të prindërve ose përgjegjësve të tij.

25. Cdo fëmijë ka të drejtë të jetojë një jetë sa më të mirë. Familja ka përgjegjësi ta ushqejë, ta veshë, t'i japë një shtëpi edhe kur i ati ndodhet në një Shtet tjetër dhe Shtetet duhet të ndihmojnë familjet në këtë detyrë në rast nevojë.

26. Fëmija ka të drejtën e shkollimit. Për të garantuar këtë të drejtë Shtetet duhet:

- të ofrojnë shkolla elementare falas dhe të detyrueshme për të gjithë;
- të garantojnë shkollën e mesme dhe të ndihmojnë ata që kanë kapacitetin për të frekuentuar;
- të informojnë fëmijët mbi shkollat e ndryshme që ekzistojnë;

Shtetet duhet gjithashtu të kontrollojnë që në shkollë të respektohen të drejtat e fëmijëve.

27. Edukimi i fëmijës duhet:

- të zhvillojë të gjitha aftësitë e tij;
- të respektojë të drejtat dhe liritë e njeriut;
- të respektojë prindërit, gjuhën dhe kulturën e vendit në të cilin jeton;
- të përgatisë atë të shkojë dakort me gjithë të tjerët; të respektojë ambientin natyror.

28. Fëmija që ka një gjuhë apo besim fetar të ndryshëm nga shumica e popullsisë ka të drejtë të përdorë gjuhën e vet, të jetojë sipas rregullave të kulturës së tij dhe të praktikojë besimin e tij fetar.

29. Fëmija ka të drejtë të luajë, të shplohët e të zbavitët. Shtetet duhet t'u garantojnë të gjithëve të drejtën e pjesëmarrjes në jetën kulturore dhe artistike të Vendit.
30. Fëmija nuk duhet të detyrohet të kryejë punë të vështira ose të rrezikshme për shëndetin dhe që pengojnë rritjen dhe shkollimin e tij. Shtetet duhet të miratojnë ligje të cilat të vendosin në çfarë moshe mund të punohet, me çfarë oraresh e kushtesh dhe duhet të ndëshkojnë ata që nuk i respektojnë këto ligje.
31. Shtetet duhet të mbrojnë fëmijët nga droga dhe të evitojnë pjesëmarrjen e tyre në shpërndarjen e drogës.
32. Shtetet duhet të mbrojnë fëmijët nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.
33. Shtetet duhet të vihen dakort për të evituar rrëmbimin dhe shitjen e fëmijëve.
34. Shtetet duhet të mbrojnë fëmijët nga çdo lloj shfrytëzimi.
35. Mbi asnjë fëmijë nuk mund të ushtrohet torturë, ndëshkim i dhunshëm, dënim me vdekje apo burgim i përjetshëm. Në rastin kur një fëmijë duhet të shkojë në burg kjo gjë duhet të ndodhë për një arsye të rëndë dhe periudha e burgimit të jetë e shkurtër. Në burg duhet të respektohet, të mbajë lidhje me familjen dhe të jetë i ndarë nga të burgosurit në moshë të rritur.
36. Në rast lufte fëmijët që nuk kanë mbushur të paktën pesëmbëdhjetë vjeç nuk duhet të thirren ushtar.
37. Në qoftë se një fëmijë është lënë pas dore, është shfrytëzuar apo keqtrajtuar, qoftë dhe për shkak të luftës, duhet të ndihmohet për t'i rikthyer shëndetin.
38. Fëmija që nuk ndjek ligjet duhet të trajtohet në një mënyrë e cila të respektojë dinjitetin e tij. Shtetet duhet të garantojnë që fëmija të quhet i pafajshëm deri sa nuk është provuar fajësia e tij, pas një procesi gjyqësor të rregullt, të garantojnë: që çështja të zhvillohet sa më shpejt; që fëmija të mos jetë i detyruar të deklarohet i fajshëm; në rast se gjykohet i fajshëm, të ketë të drejtën e rishikimit të vendimit; në rast se nuk flet gjuhën e vendit në të cilin gjykohet t'i ofrohet asistenca e një përkthyesi, të respektohet jeta e tij private, etj.
39. Ligjet e një Shteti mund të mos zëvendësohen nga artikujt e kësaj Marrëveshjeje në rastin kur ato janë akoma më të favorshme për fëmijët.

PJESA E DYTE

40. Shtetet impenjohen t'u bëjnë të ditur këtë Marrëveshje si fëmijëve ashtu dhe të rriturve.
41. Shtetet duhet të emërtojnë një komitet ndërkombëtar që të mblihet herë pas here për të kontrolluar nëse të drejtat e fëmijëve respektohen.
42. Cdo pesë vjet Shtetet duhet të informojnë sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (ONU) dhe Komitetin, mbi punën e bërë për respektimin e të drejtave të fëmijëve.

43. Kombet e Bashkuara mund të ngarkojnë orgnizata ndërkombëtare të specializuara, si UNICEF etj, për të kontrolluar se si respektohen të drejtat e fëmijëve në të gjitha Shtetet e botës.

PJESA E TRETE

44. Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet nga të gjitha Shtetet e botës.

45. Marrëveshja duhet të kthehet në ligj në çdo Shtet.

46. Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet edhe mbas aprovimit, nga Shtete të tjera që duan ta adoptojnë më vonë.

47. Marrëveshja ka hyrë në fuqi 30 ditë më vonë pasi 20 Shtetet e para e adoptuan.

48. Cdo Shtet mund të propozojë ndryshime në përmbajtjen e Marrëveshjes duke ia dërguar këto propozime sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

49. Sekretari i përgjithshëm do t'u bëjë të ditur të gjitha Shteteve gjykimet dhe dyshimet që çdo Shtet ka shprehur kur ka adoptuar Marrëveshjen.

50. Një Shtet mund të kundërshtojë Marrëveshjen duke i shkruar sekretarit të përgjithshëm.

51. Marrëveshja ndodhet e depozituar tek sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

52. Teksti zyrtar i kësaj Marrëveshjeje është i shkruar në gjuhë arabe, kineze, anleze, franceze, ruse dhe spanjolle.

Përkthim jo zyrtar nga Alsi Rakipaj nënkryetar i këshillit komunal të fëmijëve të Kamponogarës (VE) dhe Violeta Zotaj.